



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2692/2 prot.,

Datë 06.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: “Ulza” SHPK me NIPT J67902928O dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Zef Jubani”, Ndërtesa 15, Hyrja 19, Ap.1, Kodi postar 1019, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina 20, Tiranë

Në datën 03.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3559, si dhe nr. protokolli 2692/2023 datë 03.11.2023 e operatorit ekonomik “Ulza” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-78172-08-23-2023, me objekt “*Drurë shkurre Dekorative*”, me fond limit 66,666,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë objektin e pretendimeve që operatori ekonomik “Ulza” SHPK parashton në

ankesën me numër ankimi elektronik me A/2023/3559, si dhe nr. protokolli 2692/2023 datë 03.11.2023.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij, ndër të tjera citon si më poshtë vijon:

“[...]

Nderkohe qe ishim ne pritje te veprimeve vijuese procedurale sipas parashikimeve te LPP, dhe konkretisht shpalljes se fituesit paraprak, shpalljes se fituesit perfundimtar dhe me pas ushtrimin e te drejtes se, pa asnje lloj njoftimi paraprak apo arsye konkrete, ne date 01.11.2023 rreth ores 1:30 jemi njoftuar nga sistemi elektronik i prokurimeve spe, se kjo procedure prokurimi eshte anuluar.

Arsyetimi i publikuar ne faqen elektronike te spe ishte: “per shkak te rrethanave te paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftesia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar. Ne sistemin elektronik eshte publikuar vetem ky njoftim, i pa shoqeruar me asnje dokument, shkrese, i cili do te jepte nje shkak konkret, apo arsyetim, lidhur me arsyet se pse autoriteti kontraktor ka anuluar proceduren e prokurimit.

Ne fakt ky veprim i autoritetit kontraktor jo vetem qe nuk ka asnje baze ligjore, por ne rastin me te mire do te konsiderohet si paaftesi totale dhe mosnjohje e theksuar e ligjit te prokurimit publik, e ne rastin me te keq do te konsiderohet si keqdashje dhe shkelje me dashje e ligjit te prokurimit publik, e ne te dyja rastet eshte shperdorimi i paster i detyres shteterore.

[...]

6.Duke marre ne konsiderate te gjithë arsyetimin e sipercituar, rezulton e qarte se qellimi dhe objektivi paresor i nje autoriteti kontraktor eshte realizimi i nje procedure prokurimi ne menyre qe AK te siguroje mallrat, sherbimet dhe punet duke realizuar keshtu funksionin e tij ekzekutiv dhe permbushjen e detyrave te veta funksionale. Nga ana tjetër, anulimi i procedures se prokurimit ne thelb nuk eshte nje procedure normale dhe sigurisht as qellim dytesor apo terciar i autoritetit kontraktor, por ne fakt eshte nje proces i jashtezakonshem i cili kryhet ne rrethana ekstreme dhe vetem kur plotesohen disa kushte e kriteret e mirepercaktuara nga ligjvënësi ne menyre shteruese ne nenin 98 te ligjit te prokurimit.

7. Duke u kthyer ne rastin konkret, ju bejme me dije se vendimi i titullarit te autoritetit kontraktor per anulimin e procedures se prokurimi, pa dhene asnje shkak ligjor apo arsyetim objektiv, eshte nje shkelje flagrante e gjithë kuadrit ligjor te sipercituar. Arsyet e cituara ne sistemin elektronik te prokurimeve, te pashoqeruara me dokumentacion e arsye mbeshtetese ne rastin me te mire do te konsiderohen si paaftesi totale dhe mosnjohje e theksuar e ligjit te prokurimit publik, e ne rastin me te keq do te konsiderohen si keqdashje dhe shkelje me dashje e ligjit te prokurimit publik, e ne te dyja rastet eshte shperdorimi i paster i detyres shteterore.

8. Me e rende akoma do te jete situata nese autoriteti kontraktor, vendos ta anulloje pa shkak ligjor kete procedure prokurimi, e me pas te vijoje me rishpalljen e saj me te njejtin objekt ose edhe me objekt te ngjashem. kjo do te ishte nje shkelje flagrante e ligjit per prokurimin publik dhe

shperdorim i paster i detyres nga titullari i autoritetit kontraktor si dhe nga te gjithë zyrtaret pergjegjes qe do te ndermarrin te tilla veprime te paligjshme.

9. Ne keto kushte vleresojme se autoriteti kontraktor ka shkelur haptazi ligjin 162/2020 “Per prokurimin public”, pasi nuk ekziston asnje nga kushtet e parashikuara ne nenin 98 te ketij ligji per anullimin e kesaj procedure prokurimi.

Referuar gjithë arsyetimit dhe kuadrit ligjor te sipecituar, kerkojme qe autoriteti kontraktor te anuloje vendimin per anulimin e procedures se prokurimit, duke vijuar me hapat e metejshem te procedures sipas ligjit, e te na jape te drejten e ushtrimit te ankimit per skualifikimin e paligjshem ndaj shoqerise tone.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 06.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri